



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I KOSOVES PER EFICIENCË TE ENERGIJES	
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST	
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND	
ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE	
Nr.Br.No.	2519/24
Nr. i fq./Br.Str./No.pg.	-2-
Data/Datum/Date:	23.12.24
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	



AMANDAMENT I MARRËVESHJES

për bashkëfinancim në projektin për Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë Banesore Sociale I, në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Komunës së Gllgovcit (Drenas).

Ky amandament bëhet me qëllim të ndryshimit të marrëveshjes fillestare të bashkëfinancimit Nr. protokoli (FKEE) 2023/24 të datës 01.11.2024, e lidhur ndërmjet Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) dhe Komunës së Gllgovcit (Drenasit), si vijon:

Palët kontraktuese:

1. **Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)**, përfaqësuar nga Driton Hetemi, në cilësinë e Drejtorit Menaxhues të FKEE-së.
2. **Komuna e Gllgovcit (Drenas)**, përfaqësuar nga Ramiz Ldrovci, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Gllgovcit (Drenas).

Duke marrë parasysh:

- Kërkesën e parashtruar nga Komuna e Gllgovcit (Drenasit) lidhur me shtyerjen e afatit të ekzekutimit të pagesës prej 10% e të vlerës së projektit, sipas Marrëveshjes bazë, me arsyetimin se Komuna e Gllgovcit (Drenasit) është duke u ballafaquar me ekzekutimin e pagesave përmbartimore të Kontratës Kolektive dhe nuk ekziston asnjë mundësi të realizohet pagesa brenda afatit të përcaktuar me marrëveshje;
- Mirekuptimin nga FKEE për situatën e krijuar buxhetore në Komunën e Gllgovcit (Drenasit);
- Marrëveshjen fillestare për bashkëfinancim Nr. protokoli (FKEE) 2023/24 të datës 01.11.2024.
- Nevojën për shtyerjen e afatit për ekzekutimin e plotë të pagesës prej 10% të vlerës së projektit;

Palët bien dakord për ndryshimet në vijim:

Neni 1

Afati për ekzekutimin e pagesës nga Komuna e Gllgovcit (Drenasit)

Ndryshohet pika 1.6.2 nga neni 1 i Marrëveshjes bazë si vijon:

nga:

- Komuna, shumë në vlerë prej **18,218.71** EUR (10% e totalit të investimit) do ta transferojë në llogarinë bankare të FKEE-së: FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGIJES me numër 1110350980010125 në bankën ProCredit Bank (PCB), brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Handwritten signature

- Komuna, shumën në vlerë prej **6,218.71** EUR (10% e totalit të investimit) do ta transferojë në llogarinë bankare të FKEE-së: FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË me numër 1110350980010125 në bankën ProCredit Bank (PCB), gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, por jo më vonë se data 30 mars 2025.

Neni 2

Pagesa e realizuar nga Komuna e Drenasit

Pagesa në vlerë prej **12,000.00** Euro, e realizuar nga Komuna e Gllgovcit (Drenas) në llogarinë bankare të FKEE-së më 11.12.2024, është reflektuar në nenin 1 të këtij amandamenti, në vlerën e obligimit për pagesë sipas marrëveshjes bazë.

Neni 3

Ndikimi në dispozitat tjera

2.1. Ky amendament nuk ndryshon ndonjë dispozitë tjetër të marrëveshjes fillestare, përveç asaj që është specifikuar në këtë dokument.

2.2 Të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes fillestare mbesin në fuqi dhe janë të zbatueshme.


Neni 3

Fuqia ligjore e amendamentit

Ky amendament hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është pjesë integrale e Marrëveshjes për Bashkëfinancim në mes FKEE-së dhe Komunës së Gllgovcit.

Palët kontraktuese:


Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë


Driton Hetemi
Drejtör Menaxhues i FKEE-së

Data: 20/11/24



Komuna e Gllgovcit (Drenas)


Ramiz Lladrovci
Kryetari i Komunës së Gllgovcit

